

Hidrocentralet e profitit të privatit në dëm të mjedisit publik

Publikimi mbështetet nga Projekti HumanRightivism i zbatuar nga Fondi i Zhvillimit të Komunitetit (CDF) dhe financuar nga Agjencia Suedeze e Bashkëpunimit për Zhvillim Ndërkombëtar.

Deklaratë mohimi:

Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura në këtë raport janë të Institutit për Politika Sociale "Musine Kokalari". Ato nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht politikën zyrtare ose pozicionin e SIDA-s, apo të Qeverisë së Suedisë.



Përgatitur & Botuar nga:

IPS "MUSINE KOKALARI"

Adresa: Rruga B, Residio 5, Hyrja B, Nr. 15-1, Ndërtuesi Dervisholli – 10 000, Prishtinë – Republika e Kosovës
info@musineinstitute.org
www.musineinstitute.org

E drejta autoriale ©2021 nga IPS "MUSINE KOKALARI". Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem riprodhimi, apo të transmetohet, në asnjë formë apo nga asnjë mjet, qoftë elektronik, apo mekanik, fotokopjues, regjistruar apo tjetër, pa lejen paraprake me shkrim nga botuesi.

Prishtinë, 2021

PËRMBAJTJA

Shkurtesat

Hyrje

01 Metodologjia

02 Legjislacioni midis moszbatueshmërisë dhe shpërfilljes

03 Kërkesat dhe standardet e Bashkimit Evropian

04 Marrëveshja Stabilizim Asociim (Uji, Energjia dhe Mjedisi)

05 Raporti i Progresit (Uji, Energjia dhe Mjedisi)

06 Dëmet mjedisore nga operimi i hidrocentraleve në rajon
(informatë e shkurtër për rastin e Shqipërisë dhe Maqedonisë)

07 Hidrocentralet në Kosovë (Lumbardhi 1, Lumbardhi 2, Belaja, Decani, dhe Radavci)

08 Të gjeturat

09 Rekomandimet

Burimet

Shkurtesat

HC – Hidrocentral

HCV – Hidrocentral i vogël

ZRRE – Zyra e Rregullatorit për Energji

KEK – Korporata Energjetike e Kosovës

AMMK – Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës

BRE – Burime të Ripërtëritshme të Energjisë

KEDS – Kompania Kosovare e Distribuimit të Energjisë Elektrike

KOSTT – Operator i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë Elektrike në Kosovë

MZHE – Ministria e Zhvillimit Ekonomik

BE – Bashkimi Evropian

MMPH – Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

MW – Megavat

MSA – Marrëveshja Stabilizim Asociim

Mwh – Megavat orë

GZ – Gazeta Zyrtare

ShC - Shoqëri Civile

UA - Udhëzim Administrativ

ARBK - Agjencioni për Regjistrimin e Biznesit në Kosovë

PKVBRE - Plani Kombëtar i Veprimit për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë

SP - Staf i përgjegjës

IPS "Musine Kokalari" - Instituti për Politika Sociale "Musine Kokalari"

Hyrje

Sipas raportit vjetor për vitin 2019 të Zyrës së Rregullatorit për Energji, prodhimi i energjisë elektrike ka qenë 5,718 GWh, prej të cilave 5,404 GWh janë nga termocentralet, ndërsa nga HC dhe BRE tjera janë 314 GWh, duke shënuar një ngritje prej 7.7% krahasuar me prodhimin në vitin 2018. Ndërsa, kërkesa e përgjithshme për energji elektrike në sistem në vitin 2019 ka qenë 6,001 GWh, e cila paraqet një rritje prej 5.8% në krahasim me kërkesën në vitin 2018.¹ Por, kjo nuk është e tëra. Për shkak të rritjes së madhe të kërkesës gjatë dimrit Kosova detyrohet të importojë energji elektrike për ta plotësuar nevojën për konsum të brendshëm. Mesatarisht 10-14% të energjisë së konsumuar gjatë sezonit të dimrit vjen nga importi. Rrjedhimisht sipas strategjisë për energji, Kosova ka nevojë për prodhim shtesë të energjisë elektrike për ta mbuluar konsumin vjetor.

Hidocentralet në parim janë një prej BRE-ve që mund të jenë të përdorshme në prodhimin e energjisë më të pastër elektrike. Mirëpo me kushtin që ato vet plotësojnë standardet dhe kriteret mjedisore të ndërtimit dhe operimit. HEC-et mund të shndërrohen në problem mjedisor atëherë kur : e përdorin krejt ujin në dispozicion, thajnë lumenjtë, shkatërrojnë habitatin natyror si pasojë e pakësimit të ujit në qarkullim, dëmtojnë aspektin viziv të natyrës kur ndërtohen në kundërshtim me estetikën e peisazhit, pakësojnë rendimentin bujqësor duke e pakësuar ujin në pjesë të caktuara në rrjedhës natyrore, ndotin një sasi të konsiderueshme të ujit gjatë operimit, etj.

Edhe sipas strategjisë për energji, por edhe në studimet e mëhershme të parafizibilitetit të kryera nga autoritetet publike në Kosovë, në territorin e Republikës së Kosovës ka shuma pak hidro potencial energjetik. Kjo për shkak se lumenjtë e Kosovës kryesisht nuk janë lumenjë të mëdhenjë e as të shpejtë, që do të siguronte fuqi të mjaftueshme të ujit për prodhim të energjisë elektrike. Rrjedhimisht në shumicën e studimeve për këtë fushë potenciali kryesor BRE shihet të jenë era dhe dielli.

Ka pasur licenca të shumta të hidrocentraleve të dhëna në vende të ndryshme që kanë ngritur shumë shqetësime dhe mosaprovime nga komunitetet lokale, si dhe nga shoqëria civile dhe nga partitë e caktuara politike. Kjo për shkak të përvojës së deritanishme që banorët lokalë kanë pasur me mënyrën e dizajnit dhe ndërtimit të këtyre hidrocentraleve. Impianti ekzistues nuk ka arritur ta ruajë mjedisin përreth duke futur ujë në tuba në distanca të gjata dhe duke bërë që rrjedha e lumit të ndryshojë ose të thahet plotësisht. Komunitetet lokale e kanë ngritur çështjen hidrocentraleve përmes protestave dhe formave të tjera të kundërshtimit duke theksuar se ndërtimi i hidrocentraleve u'a ka vështirësuar jetën.

Instituti për Politika Sociale « Musine Kokalari » konsideron që mirëqenia e qytetarëve duhet të jetë e para në hierarkinë e përparësive publike. Ndërtimi i hidrocentraleve, përkatësisht lëshimi i lejeve për ndërtimin e tyre duhet fillimisht të bazohet në efektin që ato kanë në komunitetin e zonës ku ato supozohen të ndërtohen. Duke qenë se efekti i

hidrocentraleve ndikon në komunitet po aq sa në mjedis, ne e konsiderojmë të domosdoshme të dalim me kërkime të duhura, të marra direkt nga baza e problemit se sa, si dhe pse hidrocentrali po ndikon në jetën e qytetarëve të zonave përreth. Një hulumtim i tillë, përveç efektit të menjëhershëm që do të prodhonte në drejtim të shpërndarjes së informacionit dhe thirrjes për arsyetim dhe ndihmë shtetërore për këta njerëz, do të gjente përdorim të vazhdueshëm të gjerë nga të gjithë palët e interesuara gjatë proceseve të reja licencimit të hidrocentraleve.

Ideja e studimit dhe hulumtimit është shfaqja e një dimensionit të ri të çështjeve të shkaktuara nga hidrocentralet, në këtë rast, shoqëror, duke mbledhur informacione përmes metodave të përafërta.

Ne konsiderojmë se është me rëndësi të madhe të jepen statistika të sakta se sa po ndryshon jeta e banorëve që jetojnë në këto zona. A është ulur rendimenti i produkteve bujqësore për shkak të mungesës së furnizimit me ujë dhe sa njerëz janë detyruar të zhvendosen si rezultat i ndotjes në ekosistem ? A ka një shkallë të lartë të rrezikut kontraktues të sëmundjeve në zonat e prekura nga ndotja e shkaktuar nga hidrocentralet ? Cilat ishin premtimet fillestare nga investitorët dhe a kanë qëndruar besnikë ndaj fjalës së tyre ? A ekziston çfarëdo përfitimi nga krijimi i hidrocentraleve në zonat përkatëse?

1. Metodologjia

Studimi për ndikimin social të hidrocentraleve është bazuar në hulumtimin mbi zbatimin e legjislacionit vendor dhe ndërkombëtar i aplikueshëm për këtë çështje, nga raportet e ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Pastaj, për t'i vërtetuar e faktuar hipotezat tona, ne jemi bazuar edhe në të dhënat që janë nxjerrë nga terreni përmes intervistave të qytetarëve që janë prekur direkt, të zyrtarëve shtetërorë që janë marrë me licencimin e hidrocentraleve, të ekspertëve të kësaj fushe dhe të shumë pjesëmarrësve në debatin për ndikimin në shoqëri nga ndërtimi i hidrocentraleve.

Stafi përgjegjës për realizimin e projektit është kujdesur që analizën e legjislacionit ta bëjë nën dritën dhe bazueshmërinë me praktikën

ndërkombëtare. Leximi i raporteve që kanë të bëjnë me këtë temë ka rezultuar me përpilimin e disa pyetësorëve, të cilët kanë nxjerrë detaje e që përbëjnë bazën e të gjeturave. Pastaj, kujdes i veçantë i është kushtuar qytetarëve dhe banorëve të lokaliteteve që janë pjesë e këtij studimi.

Hulumtuesit e Institutit për Politika Sociale « Musine Kokalari » kanë realizuar intervista me dhjetëra persona, ashtu që të gjeturat të bëhen pjesë e politikave shtetërore, nga cilado qeveri në pushtet. Instituti për Politika Sociale falenderon të gjithë pjesëmarrësit për gatishmërinë e tyre.

2. Legjislacioni midis moszbatueshmërisë dhe shpërfilljes

Kuvendi i Republikës së Kosovës ka arritur të miratojë e njëherit të ndryshojë dhe plotësojë me dhjetëra ligje të cilat e përbëjnë legjislacionin primar për energjinë që prodhohet në Kosovë. Për më tepër, aspektit ligjor i shtohet gama e gjerë në fuqi e dhjetëra akteve nënligjore me të cilat funksionojnë dhe operojnë institucionet përkatëse publike në Kosovë. Domethënë, pakkush është ankuar se vendit tonë i mungon legjislacioni që e rregullon këtë çështje. Ajo që është vërejtur më shumë dhe ku duhet vërë theks të veçantë është mungesa e zbatimit e në shumë raste shpërfillja e ligjit.

Instituti për Politika Sociale "Musine Kokalari" ka analizuar legjislacionin primar dhe sekondar kosovar, si dhe legjislacionin ndërkombëtar të zbatueshëm në vendet e tjera, e po ashtu edhe që ishte dashur të zbatohet në përpikëri edhe në Kosovë, duke krijuar standard të njëjtë me vendet e Bashkimit Evropian.

Procesi i aplikimit për vendosjen në funksion të një hidrocentrali kalon nëpër shumë kërkesa për

licencime e leje të tjera që lidhen me legjislacionin kosovar.

Nëpër nëntë (9) ligje duhet kaluar për ta legalizuar ndërtimin dhe funksionalizimin e një hidrocentrali: Ligji Nr. 03/L-184 për Energjinë, Ligji Nr. 03/L-185 për Rregullatorin e Energjisë, Ligji Nr. 03/L-201 për Energjinë Elektrike, Ligji Nr. 03 L-025 për mbrojtjen e mjedisit, Ligji Nr. 03 L-214 për vlerësimin e ndikimit në mjedis, Ligji Nr. 03 L-230 për vlerësimin strategjik mjedisor, Ligji Nr.04/147 për ujërat e Kosovës, Ligji Nr. 03 L-233 për mbrojtjen e natyres, Ligji Nr. 03 L-043 për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes. Në lidhje me këtë legjislacion, procesi i tillë përshkohet duke komunikuar përmes shkresave dhe takimeve, me dhjetëra institucione qeveritare dhe publike : Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit, Departamenti për inspektim të mjedisit, Agjencia Kosovare e Pyjeve, me Drejtoritë e Parqeve Kombëtare përkatëse.

Kushtet e marrjes së licencave dhe lejeve për energji të ripërtërishme²

Hapi 1: Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë

- > Regjistrimi i biznesit

Hapi 2: Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

- > Leja për mbrojtjen e mjedisit
- > Leja për shfrytëzimin e ujërave (nëse flitet për hidroenergji)
- > Leja e ndërtimit (për kapacitete të instaluar mbi 20MË)

Hapi 3: Lejet varësisht nga lokacioni i ndërtimit

- > Agjencia e Pyjeve e Kosovës (nëse preket ndonjë pyll)
- > Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (nëse preket ndonjë zonë e interesit të veçantë/zonë arkeologjike)

Hapi 4: Ministria e Infrastrukturës

- > Leja për kyçje në infrastrukturën ekzistuese rrugore

Hapi 5: Komuna

- > Leja e ndërtimit (për kapacitete të instaluar nën 20MW me Ligjin e vjetër, ndërsa me Ligjin e ri nën 10 MW)
- > Kontrata për shfrytëzim të tokës

Hapi 6: KEK

- > Autorizimi për kyçje në sistemin e shpërndarjes së energjisë
- > Kontrata për blerjen e energjisë nga furnizuesit. Në rast të tarifave stimuluese, nga furnizuesi publik.

Hapi 7: Zyra e Rregullatorit të Energjisë

- > Autorizimi për gjenerim të energjisë

Regjistrimi në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës**Hapi 1**

Fillimisht, një proces i tillë kërkon që një person duhet të aplikojë për t'u regjistruar si biznes në Agjencinë e Regjistrimit të Biznesit të Kosovës (ARBK), ose nëse ekziston si i regjistruar, përcjell procedurën e mëtejme. Procedura e mëtutjeshme është e rregulluar me Ligjin për Shoqëritë Tregtare, ligji i cili është i lehtë dhe i qasshëm për të gjithë.

Hapi 2

Biznesi i regjistruar duhet të aplikojë në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për t'u pajisur me leje për mbrojtjen e mjedisit, lejen për shfrytëzimin e ujërave (nëse flitet për hidroenergji), si dhe lejen e ndërtimit (për kapacitete të instaluar mbi 20MW)

² Ministria e Integritimit Evropian, Botim i Task Forcës për Integrim Evropian

Leja për mbrojtjen e mjedisit

Aplikuesi e paraqet kërkesën për t'u pajisur me pëlqimin mjedisor në Ministrinë e Mjesdisit dhe Planifikimit Hapësinor. Pasi që një vendim i tillë merret në Ministri, ai Propozim-vendim i nënshtrohet debatit publik, përgjegjësi e cila i veshet aplikuesit i cili duhet të përgatitë një plan, e që duhet ta dërgojë për miratim në Ministri, përmes së cilit caktohen kushtet teknike të organizimit të debatit, lokacioni, data e debatit, mekanizmat dhe kohën e informimit publik, si dhe lokacionet ku ekspozohen Raporti i VNM, përmbledhja joteknike e raportit të VNM dhe propozimi i vendimit. Të gjitha çështjet lidhur me debatin rregullohen me akt nënligjor i cili përcakton kohën se kur duhet të mbahet (në afat prej njëzet (20) deri tridhjetë (30) ditësh pas informimit të autoriteteve mjedisore dhe publikut të interesuar, e në të njëjtën kohë, ai këtë informim duhet ta bëjë nëpërmes mjeteve të

informimit, ku përfshihet shpallja më së paku në një gazetë ditore.

Diskutimi publik i mbajtur sipas paragrafit të mësipërm dhe informatat e mbledhura në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis merren parasysh që të sjellet një vendim për Pëlqim Mjedisor. Është përgjegjësi e organeve përgjegjëse, që në afat prej brenda shtatëdhjetë (70) ditëve nga pranimi i Raportit të VNM-së, të sjellin propozim-vendimin për ta bërë atë përfundimtar ose për ta refuzuar dhe atë në afat prej dhjetë (10) ditësh nga prezantimi i propozim-pëlqimit mjedisor. Një vendim i tillë u dërgohet aplikuesit, komunës përkatëse, si dhe opinionit publik, të cilët duhet të njoftohen për përmbajtjen e vendimit dhe kushtet e tjera, si dhe për arsyet kryesore dhe elementet mbi të cilat është bazuar vendimi.

Regjistrimi në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës

Lëshimi i lejeve për shfrytëzimin e ujërave bëhet duke i marrë për bazë dispozitat e Ligjit për Ujërat. Sipas këtij ligji, një leje e tillë lëshohet për qëllimet si nxjerrje të ujit, shkarkim të ujërave të ndotura, ndërtimin, rindërtimin ose demelimin e objekteve që ndikojnë në regjimin ujqor, aktivitetet e minierave dhe punimet gjeologjike, të cilat ndikojnë në regjimin e ujërave, shfrytëzimin e rërës, zhavorrit, gurit dhe argjilat, si dhe aktivitetet e tjera që mund të ndikojnë në regjimin ujqor.

Këto leje lëshohen nga dy institucione: Ministria për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor dhe komunat përkatëse, varësisht nga kërkesat që parashtrohen. Ministria lëshon leje për Hidrocentralet,

termocentralet, ngrohtoret me fuqi të instaluar më të madhe se 5 MG, ndërsa Komunat për marrjen e ujit nga burimet për furnizim publik me ujë deri 5000 banorë ekuivalent, furnizim me ujë për m e s krojeve publike; hapjen e puseve individuale ose publike, ujitjen e tokave në sipërfaqe deri 100 ha; marrjen e ujit nga burimet me rëndësi lokale.

Në rastin e ndërtimit të hidrocentraleve, lëshohet leje ujqore, e cila çështjen e shfrytëzimit të ujit për hidroenergji e ka rregulluar duke u siguruar që ajo lëshohet përmes koncesionit dhe që shuma e realizuar nga kjo kontratë shkon në buxhetin e Kosovës.

Leja e ndërtimit

(për kapacitete të instaluar mbi 20MW)

Hapi 3

Me Ligjin për Pyjet e Kosovës, pyjet janë përcaktuar si resurse kombëtare të cilat udhëhiqen në atë mënyrë³ për të ofruar rendimente me vlerë dhe në të njëjtën kohë të ruhet biodiversiteti për të mirën e gjeneratave të tashme dhe të ardhshme. Udhëheqja e pyjeve do t'i marrë parasysh gjithashtu edhe interesat të tjera publike". Kurse, për çështjet që lidhen në tërësi dhe në veçanti me pyjet, ekskluziviteti i është dhënë Agjencisë së Pyjeve të Kosovës e cila është përgjegjëse për rregullimin e pyjeve dhe tokave pyjore, administrimin dhe menaxhimin e tokave pyjore publike dhe pyjeve në Parqet Nacionale në Kosovë, përveç atyre çështjeve që ligji në mënyrë të veçantë i cakton ndonjë autoritet tjetër të Qeverisë.

Lëshimi i lejeve në lidhje me hidrocentralet, kërkohet në këtë agjenci nëse ndërtimi i hidrocentraleve e prek ndonjë pyll dhe nëse ky ndërtim prek ndonjë zonë të interesit të veçantë ose zonë arkeologjike, leje për të cilën aplikohet në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Hapi 4

Ndërtimi i hidrocentraleve, prek edhe çështjet që kanë të bëjnë me rrugët publike lokale dhe kombëtare. Për këtë arsye është e nevojshme pasjisa me leje për kyçje në infrastrukturën ekzistuese rrugore, në përgjegjësinë e Ministrisë së Infrastrukturës.

Hapi 5

Kjo çështje përfshinë edhe organet komunale. Atyre i është veshur autorizimi që të lëshojnë leje të ndërtimit për kapacitete të instaluar nën 20MW dhe për kontratën e shfrytëzimit të tokës.

Hapi 6

Pajisja me dokumente vazhdon tutje me dokumentin e domosdoshëm: Autorizimi për kyçje në sistemin e shpërndarjes së energjisë, si dhe kontratën për blerjen e energjisë nga furnizuesit.

Hapi 7

Hapi i fundit është drejtimi për tek Zyra e Rregullatorit të Energjisë për t'u pajisur me Autorizimin për gjenerim të energjisë elektrike.

³ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2566>

3. Kërkesat dhe standardet e Bashkimit Evropian

Politikat e Bashkimit Evropian për mjedisin, e sidomos kur bëhet fjalë për ndërtimin dhe operimin e hidrocentraleve janë shumë të gjera dhe komplekse. Por ato janë afirmative dhe strikte kur bëhet fjalë për mbrojtjen e mjedisit nga operatorët që e prodhojnë energjinë elektrike përmes shfrytëzimit të ujit.

Në vijim do të fokusohemi te disa nga direktivat evropiane, që shtetet anëtarë të BE-së dhe ato që aspirojnë të bëhen pjesë e këtij institucioni duhet t'i respektojnë dhe t'i bëjnë pjesë të politikave të tyre shtetërore.

1. Direktiva 2004/35/CE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të Unionit Evropian mbi përgjegjësinë mjedisore në lidhje me parandalimin dhe sanimin e dëmit mjedisor

Kjo direktivë përcakton një kornizë të bazuar në parimin se ndotësi paguan për të parandaluar dhe korigjuar dëmet mjedisore. Ajo është e fokusuar në dëmin mjedisor që shkaktohet të speciet e mbrojtura, habitatet natyrore, dëmtimin e ujit dhe tokës. Kjo Direktivë i bën përgjegjës direkt operatorët të cilët kryejnë aktivitete të rrezikshme e që bien nën përgjegjësi të rreptë (nuk ka nevojë të vërtetimit të fajit). Për këtë çështje, gjithmonë kërkohet vendosja e një lidhje shkakësore midis aktivitetit dhe dëmit. Personat fizikë ose juridikë të prekur dhe OJQ-të mjedisore kanë të drejtë të kërkojnë nga autoriteti kompetent të vendosë për masat përmirësuese.

Masat e përshtatshme për të siguruar sanimin e dëmtimit mjedisor:

Çdo dëmtim mjedisor në lidhje me ujin ose speciet e mbrojtura, apo hapësirat e natyrës duhet të rikthehet në gjendjen e mëparshme përmes rehabilitimit primar, plotësues dhe kompensues. Këto veprime do të kontribuojnë në kthimin e burimeve natyrore të dëmtuara në gjendjen fillestare.

Për më shumë, kjo direktivë nuk i parandalon shtetet që të mbajnë ose të miratojnë dispozita më të rrepta në lidhje me parandalimin dhe sanimin e dëmtimit të mjedisit.

2. Direktiva 2008/99 EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të Evropës mbi mbrojtjen e mjedisit përmes rrugëve penale

Në të drejtën penale nuk përbën krim vetëm ai ndaj një njeriu ose ndaj shumë njerëzve. Në legjislacionin bashkëkohor, si terminologji dhe si vepër penale konsiderohen edhe krimet mjedisore, veprimet të cilat shkaktojnë dëme ose rrezik të konsiderueshëm për mjedisin dhe shëndetin e njeriut. Veprime të tilla, të konsideruara si krime mjedisore janë: emetimi ose shkarkimi i paligjshëm i substancave në ajër, ujë ose tokë, tregtia e paligjshme e jetës së egër, tregtia e paligjshme e substancave që shkatërrojnë ozonin dhe transportimi i paligjshëm ose hedhja e mbeturinave.

Sepse këto krime shkaktojnë dëme të konsiderueshme në mjedis. E në anën tjetër, veprimet e tilla ofrojnë fitime shumë të larta për autorët e veprimeve dhe rreziqe relativisht të ulëta të zbulimit. Në këtë kuptim është miratuar edhe Direktiva Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të Evropës mbi mbrojtjen e mjedisit përmes ligjit penal. Kështu u pa dhe u arsyetua nga Këshilli i Drejtësisë dhe i Punëve të Brendshme që e ka miratuar këtë direktivë në tetor të vitit 2008.

Kërkesat nga kjo direktivë për t'u zbatuar në ligjet penale kombëtare/shtetërore:

Lista e veprave mjedisore që duhet të konsiderohen penale nga shtetet anëtare, por edhe nga shtetet që aspirojnë janë të shumta. Ato mund të kryhen me dashje ose me neglizhencë të rëndë. Nxitja, ndihma dhe përkrahja e kryerjes së këtyre veprave duhet të jetë e dënueshme si vepër penale. Shteteve u kërkohet të sigurohen që personat juridikë mund të mbajnë përgjegjësi për shkeljet e kryera për përfitimin e tyre. Veprat penale të kryera duhet të jenë subjekt i sanksioneve penale efektive, proporcionale dhe dekurajuese. Për personat juridikë sanksionet mund të jenë të natyrës jokriminale. Direktiva nuk interferon në pjesën procedurale të legjislacionit penal e as nuk prek kompetencën vendore të prokurorisë dhe gjykatave.

3. Direktiva 2009/28/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të Evropës mbi promovimin e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme

Direktiva 2009/28 siguron kornizën në të cilën të gjithë shtetet anëtare dhe ato që pretendojnë të bëhen në një të ardhme pjesë e BE-së, mund të vendosin Planet e tyre Kombëtare për rritjen e përdorimit të Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë (BRE), në mënyrë që të përmbushin objektivat e energjisë të Bashkimit Evropian. Përmbushja e këtyre objektivave kërkon që këto shtete t'ia kushtojnë një sasi të konsiderueshme burimesh financiare kërkimit dhe zhvillimit në lidhje me teknologjitë e energjisë së rinovueshme. Në këtë kuptim, kërkesat që rrjedhin nga kjo direktivë janë të detyrueshme për shtetet anëtare, që ato të futin në rregulloret dhe kodet e brendshme masat e duhura për ta rritur pjesën e të gjitha llojeve të energjisë nga burimet e rinovueshme në këtë sektor.

4. Direktiva 2011/92/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit për vlerësimin e ndikimeve që shkaktohen në mjedis nga projekte publike dhe private

Njëri nga instrumentet më të rëndësishme evropiane, në lidhje me mbrojtjen e mjedisit është Direktiva për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis. Kjo direktivë ka pësuar shumë ndryshime prej se është miratuar. Ndryshimet e fundit i kanë kushtuar vëmendje më të madhe kërcënimeve dhe sfidave që janë shfaqur si efikasiteti i burimeve, ndryshimi i klimës dhe parandalimi i katastrofave, të cilat tani reflektohen më mirë në procesin e vlerësimit. Sipas kësaj direktive, vlerësimi i ndikimit në mjedis duhet t'i identifikojë dhe të vlerësojë në mënyrë të përshtatshme, në dritën e secilit rast individual dhe të drejtpërdrejtë, efektet indirekte të një projekti në faktorët e mëposhtëm:

a) qeniet njerëzore, fauna dhe flora; b) toka, uji, ajri, klima dhe peizazhi; c) pasuritë materiale dhe trashëgimia kulturore

4. Marrëveshja Stabilizim Asociim (Energjia dhe Mjedisi)

Në nëntor të vitit 2015 më shumicë absolute të votave, Kuvendi i Kosovës e ratifikoi Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit. Kjo marrëveshje e rëndësishme ndërkombëtare parasheh edhe çështjet që lidhen me energjinë/burimet e ripërtëritshme dhe mjedisin, të cilat duhet të integrohen në politikat vendore dhe të cilat duhet të jenë në pajtim dhe të lidhura me kërkesat për zhvillimin e harmonizuar social. MSA i obligon palët të zhvillojnë dhe forcojnë bashkëpunimin e tyre në fushën e energjisë në përputhje me parimet e ekonomisë së tregut dhe të Traktatit themelues të Komunitetit të Energjisë i nënshkruar në Athinë më 25 tetor të vitit 2005. Marrëveshja i siguron dhe e mbështet Kosovën në zbatimin e acquis të BE-së për eficiencën e energjisë, burimeve të ripërtëritshme të energjisë, si dhe ndikimit mjedisor nga sektori i energjisë, duke nxitur kështu kursimin e energjisë, eficiencën e energjisë, energjinë e ripërtëritshme, si dhe hulumtimin dhe zbutjen e ndikimit mjedisor nga prodhimi i energjisë dhe konsumi.

Neni 115 i kësaj marrëveshje e obligon Kosovën të përpilojë politika të integruara për ndalimin e degradimit të mëtejshëm mjedisor dhe fillimin e përmirësimit të gjendjes mjedisore me qëllim të zhvillimit të qëndrueshëm në Kosovë.

Zbatimi i Programit Kombëtar për MSA-në

Sipas raportit të zbatimit të programit kombëtar për MSA-në, konkretisht te kapitulli i Mjedisit, rezulton se gjatë vitit 2020 janë zbatuar 40% e masave, ndërsa 60% e tyre nuk janë zbatuar.⁴

Ne jemi ndalur tek masat që nuk janë zbatuar e të cilat sipas raportit, përbëjnë vonesa serioze në miratimin e shumicës së masave të planifikuara të kornizës legjislative (primare dhe sekondare).

Masat e pazbatuara janë:

- > Miratimi nga Qeveria i projektligjit për mbrojtjen e ajrit nga ndotja;
- > Miratimi nga Qeveria i projektligjit për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotje
- > Miratimi nga Qeveria i projektligjit për ujërat e Kosovës;
- > Miratimi nga Qeveria i projektligjit për pyjet;
- > Miratimi i UA për rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes;
- > Miratimi i Planit të Veprimit 2020-2022 për zbatimin e Strategjisë Shtetërore të Ujërave në Kosovë 2017-2036;
- > Identifikimi i aglomerateve në pellgun e Lumit Drini i Bardhë;
- > Përcaktimi i zonave të ndjeshme sipas direktivës për trajtimin e ujërave të ndotura urbane.

⁴ <https://www.mei-ks.net/repository/docs/Raport%20mbi%20zbatimin%20e%20PKZMSA%20qjate%20vitet%202020.pdf>

5. Raporti i Progresit 2020 (Uji, Energjia dhe Mjedisi)

Raporti i Progresit është një instrument përmes së cilit Komisioni Evropian e mat nivelin e progresit të një vendi në përmbushjen e agjendës evropiane brenda vitit kalendarik. Raporti publikohet një herë në vit dhe atë në fillim të tetorit të çdo viti. Si i tillë, raporti trajton çështjet duke filluar nga çështjet themelore, si kriteret politike, sundimi i ligjit, demokracia, duke vazhduar te marrëdhëniet e mira fqinjësore dhe bashkëpunimi rajonal e duke përfunduar te mjedisi, energjia, shoqëria e informacionit, mediat dhe kontrolli financiar.

Për hulumtimin dhe studimin tonë janë të rëndësishme energjia dhe mjedisi.

Njëra ndër politikatat që ndjek dhe promovon Bashkimi Evropian është ajo mbrojtjes së mjedisit. Legjislacioni i BE-së përmban dispozita speciale që adresojnë çështjet e ujit, energjisë dhe mbrojtjen e natyrës.

Mjedisi

> Kosova larg tranzicionit të gjelbër

Raporti për vitin 2020 tregon se rekomandimet e bëra nga raporti për vitin 2019 janë ende në pritje dhe Kosova nuk ka arritur ende të orientohet drejt një tranzicioni të gjelbër. Në veçanti, raporti thekson se Kosova ka dështuar:

- > Të krijojë një sistem efektiv të monitorimit të ujërave, të publikojë të dhëna dhe të ndërmarrë masa urgjente dhe të përhershme, për të zvogëluar ndotjen e ajrit dhe ujërave;
- > Të zbatojë dispozitat ligjore për përgjegjësinë, dëmtimin dhe krimin mjedisor; zbatimin e parimit ndotësi paguan, krijimin dhe fillimin e një fushate të përhershme për rritjen e ndërgjegjësimit të publikut për mbrojtjen e mjedisit dhe;
- > Të zbatojë strategjinë e ndryshimeve klimatike dhe planin e veprimit për ndryshimet klimatike, të përgatisë një udhërrëfyes për përafrimet me acquis të BE-së për klimën dhe të fillojë punën për një plan të energjisë dhe klimës, në përputhje me kërkesat e Komunitetit të Energjisë.

> Kosova larg tranzicionit të gjelbër

Më tej, raporti tregon për mungesën e përditësimit të zbatimit të Strategjisë Mjedisore 2011-2021. Ka një përafrim në forcimin e dispozitave të Kodit Penal mbi krimin mjedisor, por ato kanë mbetur joefektive deri më sot. Vërehet mungesë e inspektorateve mjedisore të cilat nuk kanë kapacitete të mjaftueshme.

> Mungesa e përafrimit të legjislacionit kosovar të ujërave me acquis të Bashkimit Evropian

Raporti vë theksin sikurse edhe raporti për zbatimin e MSA-së, se asnjë progres nuk është bërë në përafrimin e legjislacionit të ujërave me acquis të BE-së. Niveli i përafrimit me legjislacionin e BE-së mbetet shumë i ulët. Duhet bërë më shumë për të siguruar zbatimin e Ligjit për Ujërat. Rrjetet e monitorimit të burimeve ujore janë ende të paplota, veçanërisht për ujërat nëntokësore dhe zonat për mbrojtjen e ujërave nuk po monitorohen ose menaxhohen si duhet. Kërkohen përpjekje urgjente për të siguruar që autoriteti i rrethit të pellgut lumor të bëhet funksional. Nuk është arritur asnjë progres në përgatitjen e planeve të menaxhimit për të gjitha pellgjet e lumenjve.

Energjia

Siç e kemi thënë edhe në tekstet e mëparshme të këtij raporti, politikat e BE-së përfshijnë të gjitha aspektet e energjisë, nga furnizimi me energji, duke vazhduar te energjia e ripërtëritshme e duke përfunduar te eficientia. Por, ne do të ndalemi tek çështjet që kanë të bëjnë me energjinë e ripërtëritshme.

> Disfunksionaliteti i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë

Raporti tregon për mungesën e seriozitetit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë e cila ka qenë pa kryetar për 3 vitet e fundit dhe se asaj është duke iu minuar pavarësia operationale për shkak të ndërhyrjeve politike të vazhdueshme.

Raporti flet për progresin në burimet e ripërtëritshme të energjisë, kryesisht një rritje e investimeve të reja, por duke u fokusuar tek ato në erë dhe diellore. Raporti vë theksin, te hidrocentralet e vogla, zhvillimi i të cilave u përball me rezistencë të fortë publike "për shkak të shqetësimeve mbi ndikimin e tyre në mjedis." Mëtej, ky raport kërkon që të gjitha këto projekte duhet të "jenë në përputhje me legjislacionin e BE-së mbi koncesionet dhe mjedisin dhe të marrin parasysh ndikimin në zonat me interes të lartë natyror."

6. Dëmet mjedisore nga operimi i hidrocentraleve në rajon (informatë e shkurtër për rastin e Shqipërisë dhe Maqedonisë)

Shqipëria

> Degradimi Mjedisor

E tërë energjia e prodhur në Shqipëri, realizohet përmes hidrocentraleve. Sipas një dokumenti raportues, të titulluar "Lumenjtë e thyer: ndikimet e hidrocentraleve të vegjël të financuara nga Evropa në peizazhet e pacënuara të Ballkanit"⁵ i publikuar nga CEE Bankwatch Network, në Shqipëri janë në përdorim 177 hidrocentrale (që nga viti 2017), ndërsa nga po i njëjti vit janë 43 hidrocentrale të cilat janë në ndërtim e sipër dhe 364 të tjerë janë planifikuar nga Ministria e Energjisë.

Në Shqipëri gjenden afërsisht 30% të specieve të florës evropiane dhe 42% të gjitarëve në Evropë, ndërsa vetëm "16% e territorit të saj mbulohet nga Zonat e Mbrojtura"

Gjetjet e Bankwatch tregojnë aspektet e degradimit të mjedisit në përgjithësi nga veprimi i hidrocentralit të Rapunit dhe Tërnovës, në Librazhd dhe në Bulqizë.

Mungesa e ujit në lumenjtë Qarrishtë dhe Rrapun vjen nga hidrocentralet Rrapuni 1 & 2 dhe shkakton ndër të tjera mungesë uji për një mulli gruri që përdoret nga 200 persona të zonës. Duke vazhduar më tutje, "hidrocentralet Rapuni 3 & 4 të cilët e kanë një lidhje njëri me tjetrin, duke thënë se ndërtimi "pa rrjedhjen ekologjike dhe pa një rrugë kalimi për peshqit është i papranueshëm dhe tregon një deficit në kontroll nga autoritetet shqiptare".⁶

Gjetjet kryesore të CEE Bankwatch Network:

- > I gjithë tubacioni grumbullues kalon mbi tokë dhe është i rrethuar nga kodra të erodura, kryesisht të përbëra nga toka argjilore. Pjesa qendrore e tubacionit në veçanti ndikohet nga erozioni, në masën që duket se ekziston rreziku i rrëshqitjes së dheut.
- > Shpyllëzimi erdhi si rezultat i punës gjermuese për të krijuar hapësirë për tubacionin;
- > Fshatarët e intervistuar ende ankohen për mungesën e ujit për vaditje;
- > Gjermimet për bazat e tubacionit, rrugët e hyrjes dhe linjat e energjisë elektrike, kanë hequr mbulesën e pemëve dhe vegjetacionit

⁵ <https://bankwatch.org/wp-content/uploads/2017/12/broken-rivers-AL.pdf>

⁶ <https://www.reporter.al/berzh-pranoi-se-hec-et-ne-shqiperi-demtojne-mjedisin-dhe-banoret-pretendojne-mjedisoret/>

Maqedonia e Veriut

> Kontestimi I Hidrocentraleve

Thëngjilli vazhdon të jetë elementi kryesor që e prodhon energjinë elektrike në Maqedoninë e Veriut. Statistikat zyrtare tregojnë se fundi i vitit 2020, këtë shtet e gjeti me vetëm 0.1 % e rrymës elektrike të prodhuar nga panelet solare, 13.8% nga hidrocentralet, 1% nga biogazi, 32.9% nga centralet e kombinuara, nga centralet e erës 1.3%, ndërsa nga termocentralet 50.8%.

Ndonëse 13.8% e prodhimit të energjisë elektrike varet nga hidrocentralet, operimi i tyre është kontestuar në vazhdimësi nga organizatat e shoqërisë civile dhe nga persona publik me ndikim në këtë shtet. Sipas tyre, ndërtimi i HC-ve të vogla duhet të ndërpritet, sepse lumenjtë dhe jeta e egër po dëmtohet. Investimet në energjinë e ripërtëritshme duhet të rriten e të intensifikohen, por jo me çmimin e shkatërrimit të lumenjve e të ndikimit të keq.

Në Maqedoninë e Veriut, Shoqëria Civile vazhdimisht ka kërkuar që të pezullohen të gjitha procedurat për lejimin e operimit të HCV-e. Sepse ndërtimi i tyre i ka dëmtuar lumenjtë, bimësinë dhe habitatet bregore. Pastaj, ndërtimi i tyre ka shkaktuar dëme të pakthyeshme në strukturat unike të relievit në gryka, e cila kur bie shi i madh e përmbys vendin. "Ndërtimi i rrugëve hyrëse në pjesët më të fshehura të maleve dhe pyjeve mundëson gjuetinë pa leje, prerjet ilegale, shqetësimin e jetës së egër dhe ndërtimin e strukturave të forta në zonat që janë planifikuar prej kohësh për mbrojtje. Ky është një problem i veçantë në rastin e zonave tona të mbrojtura".⁷

Ambientalistët kanë thënë se investimet në energjinë e ripërtëritshme duhet të rriten dhe shteti duhet të gjejë mekanizma për t'i inkurajuar ato, por jo me çmimin e shkatërrimit të natyrës.

⁷ <https://kosovo.energy/ambientalistet-ne-maqedoni-kundershtojne-hidrocentralet-e-vogla/>

7. Hidrocentralet në Kosovë

(Lumbardhi 1, Lumbardhi 2, Belaja, Deçani dhe Radavci)

Në vitin 2006, Kosova u bë pjesë e Komunitetit të Energjisë.⁸ Sipas Direktivës së BE-së të Energjisë së Ripërtërishme, vendet e këtij komuniteti duhet të miratojnë plane kombëtare për Burimet e Ripërtërishme të Energjisë (PKVBRE), e cila duhet të përmbajë qëllimet, synimet dhe caqet për burimet e ripërtërishme në totalin e shfrytëzimit të energjisë elektrike. Ministria e Zhvillimit Ekonomik, e cila e mbikëqyr dhe zbaton energjetikën kosovare, ka përcaktuar cakun prej 25% të energjisë elektrike së përgjithshme, e cila duhet të sigurohet nga energjia e ripërtërishme.

Studimet e bëra në vitin 2006, 2009 dhe 2010, tregojnë për potencialin e vendit për HC-të e vogla, të cilat do të ngriten nga investimet e kapitalit privat.

Vlerësimet e këtyre studimeve tregojnë se potenciali i prodhimit të energjisë nga uji arrin rreth 130 MW të kapaciteteve të reja të instaluara, me prodhimmesatar vjetor prej 621 GWh.

Sipas caktimit promovues, energjia elektrike e prodhuar nga hidrocentralet do të duhej të arrinte në 240 MW, cak i cili parashihet në Planin Kombëtar i Veprimit për Burimet e Ripërtërishme të Energjisë.⁹

IPS "Musine Kokalari", në kuadër të projektit "Ndikimi Social i Hidrocentraleve në Shoqërinë tonë" është fokusuar në zonën e Rrafshit të Dukagjinit, ku fokusi te hidrocentralet ka qenë i hershëm dhe më i madh. Hidrocentralet që ne i kemi marrë për bazë të studimit dhe hulumtimit janë Lumbardhi 1, Lumbardhi 2, Radavci, Belaja dhe Deçani.

- Hidrocentrali i vogël Lumbardhi I është rivendosur në vitin 2005, me një qera prej 20+20 viteve. Kapaciteti i saj arrin në 8.5 MW.

- Hidrocentrali i vogël Lumbardhi II është instaluar në vitin 2016, me kapacitet 6.2 MW.

- Hidrocentrali i vogël Radavci është rifunksionalizuar në vitin 2010 dhe është marrë me koncesion. Kapacitetet e këtij HCV ka arritur në 0.8 MW.

- Hidrocentrali i vogël Deçani është në pronësi të kompanisë "Kelkos Energy" sh.p.k. Kapacitetet e këtij HCV kanë arritur në 9.8 MW. Ai ndodhet në Zonën e Veçantë të Mbrojtur afër Manastirit të Deçanit. Më 12 nëntor 2020, ZRE i ka dhënë leje kompanisë austriake KELKOS. Një licencë 40 vjeçare për të prodhuar energji nga ky hidrocentral.

- Hidrocentrali i vogël Bellaja është në pronësi të kompanisë "Kelkos Energy" sh.p.k. Kapacitetet e këtij HCV kanë arritur në 8.06 MW. Ai ndodhet në Zonën e Parkut Nacional. Me 12 nëntor 2020, ZRE i ka dhënë leje kompanisë austriake KELKOS. Një licencë 40 vjeçare për të prodhuar energji nga ky hidrocentral.

⁸ <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32006D0500&from=EN>

⁹ <http://www.kryeministri->

[ks.net/repository/docs/PLANI_KOMBETAR_I_VEPRIMIT_PER_BURIMET_E_RIPERTERITSHME_TE_ENERGJISE_\(PKVBRE\)_2011-2020.pdf](ks.net/repository/docs/PLANI_KOMBETAR_I_VEPRIMIT_PER_BURIMET_E_RIPERTERITSHME_TE_ENERGJISE_(PKVBRE)_2011-2020.pdf)

8. Të gjeturat

Neni 52 [Përgjegjësia për Mjedisin Jetësor] i Kushtetutës së Republikës së Kosovës kërkon vendimmarrje plebishitare për sa i përket çështjeve mjedisore. Pika 1 e këtij Neni e bën secilin qytetarë të Kosovës pa dallim përgjegjës për natyrën e biodiversitetin, po ashtu edhe për mjedisin jetësor ku jeton. Kjo lloj përgjegjësie që derivon nga Kushtetuta është përgjegjësi që rrjedh nga e drejta sovrani, të cilën qytetari e gëzon brenda hapësirës politike ku jeton.

> Shkelja e të drejtave politike

(vendimmarrjen dhe të drejtën për të qenë të informuar)

Përmes kësaj fryme, Kushtetuta e Republikës së Kosovës të drejtës për mjedisin ia bashkëngjet të drejtat politike (vendimmarrjen dhe të drejtën për të qenë të informuar), duke i vlerësuar të drejtat mbi mjedisin në kuadër të të drejtave themelore të njeriut sipas parimeve ndërkombëtare të të Drejtave Ekonomike, Sociale dhe Kulturore.

Kjo është një prej të drejtave themelore e cila është shkelur vazhdimisht nga vendimet për ndërtimin e HC-ve në Komunën e Deçanit (subjekt të këtij trajtimi). Shumica dërrmuese e banorëve të intervistuar janë deklaruar se për këto HC është mbajtur VETËM nga një takim publik

Duke qenë përgjegjësi ajo është edhe e drejtë – që nënkupton se vendimet që prekin mjedisin na takojnë secilit, meqëç farëdo prekje e mjedisit, natyrës e biodiversitetit na prek të gjithëve e secilin veç e veç.

Kjo logjikë pastaj bartet te pika 2 e të njëjtin Nen kushtetues e cila obligon institucionet publike që të angazhohen për t'i garantuar secilit mundësinë që të ndikojë në vendimet që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor ku jeton.

për katër HC-të e ndërtuara në Grykën e Deçanit.

Të intervistuarit konsiderojnë që takimi publik ka qenë qëllimisht i organizuar keq, ashtu që ta pamundësojë pjesëmarrjen e banorëve. Në vend se të mbahet në një prej hapësirave zyrtare komunale, ai ishte mbajtur në një restorant. Ftesa ishte publikuar në një prej gazetave ditore dhe me kaq kishte marrë fund njoftimi i qytetarëve.

Ata pak qytetarë që kishin marrë pjesë tregojnë se më shumë se sa debat për HC ka pasur premtime nga përfaqësuesit e kompanisë për përfitimet ekonomike e sociale që rrjedhin nga ndërtimi i HC-ve në territorin e Komunës.

> Nga mjedisi si e mirë publike në mjedis si mjet të ekonomisë së ofertës

Kjo qasje e institucioneve publike karshi vendimeve të rëndësishme për mjedisin dhe komunitetin shpërfaq devijimin institucional nga parimet kushtetuese të Kosovës. Për sa kohë që Kushtetuta në frymë e vendos MJEDISIN në nivel të së mirës publike dhe sociale, sjellja e institucioneve e degradojnë atë në mjet të ekonomisë, dhe atë VETËM në mjet të ekonomisë së ofertës.

Sipas definicionit të organizatës globale Friends of the Earth, e drejta mbi mjedisin nënkupton qasje në

resurset e paprekura natyrore që mundësojnë mbijetesën, përfshirë tokën, strehimin, ushqimin, ujin dhe ajrin.

Në këtë drejtim e drejta mbi mjedisin është drejtpërdrejt e lidhur me mirëqenien, me mundësinë për një jetë më të mirë.

Ndërkohë që për sa i përket HC në Grykën e Deçanit nuk ka të dhëna për kontributin e tyre në përmirësimin e jetës së komunitetit.

Për ta përmbushur synimin 20/20/20, autoritetet e Kosovës kishin planifikuar që të instalojnë këto kapacitete të ripërtëritshme në sistemin energjetik të Kosovës:

- > 150 MW energji me erë,
- > 10 MW energji fotovoltaike (diell),
- > 240 MW hidro energji, dhe
- > 14 MW biomasë.

Çmimi nxitës për hidro energji ishte caktuar në 67.3 euro për MW/h.

Hidropotenciali i lumenjëve të Kosovës është koga i kufizuar për sa i përket prodhimit të energjisë elektrike.

Nr.	River	Station	River	Q _{min}	Q _{max}	Q _{ave}
1		Berkovë	Istogut	0.48	186	3.75
2		Drelaj	Bistrica e Pejës	0.32	83.5	4.2
3		Grykë	Bistrica e Pejës	0.46	194	5.95
4		Klinë	Klina	0	49.2	1.49
5	Drini i Bardhë	Mirushë	Mirusha	0.02	23.3	1.21
6		Deçan	Bistrica e Deçanit	0.6	58	4.28
7		Rakovinë	Drini i Bardhë	0.6	358	24.64
8		Gjakovë	Ereniku	0.06	542	12.33
9		Piranë	Toplluha	0.04	55.4	3.47
10		Gjonaj	Drini i Bardhë	0.1	1118	48.8
11		Prizren	Bistrica e Prizrenit	0.03	424	4.47
12		Drenas	Drenica	0.02	32.8	1.52
13		Lluzhan	Llapi	0.9	63.8	5.01
14	Ibri	Nedakovc	Sitnica	0.5	328	13.2
15		Millosevë	Llapi	0	82.7	4.48
16		Prelez	Ibri	0.8	452.8	13.39
17		Leposaviq	Ibri	0.5	667	30.85
18	Morava e Binçës	Konçul	Morava e Binçës	0.03	1012	9.21
19		Dumarovc	Kriva Reka	0.2	30.8	2.6
20		Viti	Morava e Binçës	0.05	18.7	1.06
21	Lepenci	Kaqanik	Nerodime	0.15	17.5	4.17
22		Hani i Elezit	Lepenci	0.1	184	10.49

Tabela 1. Paraqet maksimumin, minimumin dhe vlerat mesatare të rrjedhës së ujit në stacionet hidrometeorologjike të Kosovës.

Me studimin e parafizibilitetit të financuar nga Ministria e Energjisë dhe Minerave të vitit 2006, ishte identifikuar potenciali edhe për 2 HECe në Lumbardhin e Deçanit: Hidrocentrali Deçan me kapacitet prej 8.3 MW dhe Hidrocentrali Belle (Belaja) me kapacitet 5.2 MW. Vlera parallogaritare për financimin e këtyre dy HEC-eve ishte vlerësuar në rreth 11 milion EUR (6.31 milion Deçani dhe 4.97 milion Belaja).

Në vitin 2011, Kelkos Energy shfaq interesim për ndërtimin e këtyre HEC-eve dhe e rive l e s o n potencialin energjetik të mjaftueshëm për 3 HEC-e në vend të dy HEC-eve të vlerësuar nga Studimi i parafizibilitetit:

- > HEC 'Deçan' - fuqi instaluese 8.4 MW (28 GWh) dhe investimin e vlerësuar prej 19 milion EUR. Me vendim të ZRRE V_813_2016 në vitin 2016 i është aprovuar Kelkos Energy ndryshimi i kapacitetit të këtij HEC-i nga 8.4 MW në 9.8 MW;
- > HEC 'Belaje' - fuqi instaluese 9.2 MW (29.7 GWh), dhe investimin e vlerësuar prej 19 milion EUR.
- > HEC 'Lumbardhi II' - fuqi instaluese 5.5 MW (11.7 GWh) dhe investimin prej 15 milion EUR. Me licencën e përkohshme të lëshuar nga ZRRE, kapaciteti i këtij HEC është rritur në 6.2 MW.

Në këto përlllogaritje Kelkos Energy kishte përfshirë edhe investimet prej 2 milion euro në HEC 'Lumbardhi 1' (Kozhnjeri).

Përmbledhtazi Kelkos kishte planifikuar dhe përlllogaritur që:

- > Fuqia instaluese të jetë 33.86 MW;
- > Energjia e gjeneruar të jetë 91.4 GWh
- > Shuma e investuar të jetë 55 milionë euro.

> Kelkos Energy: Investimet dukshëm më të vogla nga studimi i parafizibilitetit

Edhe fuqia instaluese, edhe potenciali energjetik, e veçanërisht investimet e nevojshme të llogaritura nga Kelkos Energy dallojnë dukshëm nga studimi i parafizibilitetit. Sipas përllogaritjeve të Kelko Energy fuqia e instaluar mund të jetë 23.36 MW krahasuar me 13.5 MW, sa ishte vlerësuar me studimin e parafizibilitetit të vitit 2006. Kjo paraqet problem të madh mjedisor e social. Vlerësimet e autoriteteve publike dhe ato të kompanisë investuese bazohen në të njëjtat parametra e burime të potencialit ujor të Lumbardhit. Studimi i parafizibilitetit ka projektuar fuqi të instaluar hidroenergjetike në bazë të kriterëve për shfrytëzimin e ujit, duke projektuar në të njëjtën kohë edhe sasinë e ujit që duhet të lihet në rrjedhën natyrore për ta mirëmbajtur minimumin ekologjik.

Ndërkohë që projektimet e Kelkos Energy kanë tjetër synim: maksimalizimin e profitit. Prandaj kalkulimet e tyre e rrisin potencialin e prodhimit të energjisë elektrike në dëm të mirëmbajtjes e ruajtjes së mjedisit.

Të njëjtën shpërputhje të shifrave e gjejmë edhe te investimet. Sipas Kelkos Energy investimet për ndërtimin e 3 HEC-eve arrijnë shumën prej 55 milionë euro gjithsej

(këtu përfshihen edhe investimet në HEC ekzistuese 'Lumbardhi 1'). Ndërsa sipas studimit të parafizibilitetit investimet në kapacitetet e reja hidroenergjetike në Lumbardh (2 HEC në vend të 3 sa ka projektuar e ndërtuar Kelkos Energy) vlerësohen se duhet të jenë 11.3 milionë euro.

Ndërsa investimi përfundimtar për 3 HEC të ndërtuara nga Kelkos Energy arrin vlerën prej 38,757,423 milionë euro. Sipas KelKos Energy, në këtë vlerë nuk është përfshirë vlera e vendosjes së kabllor nëntokësore të tensionit të lartë 35 kV dhe ndërtimi i transformatorit 5/110 kV në nënstacionin Deçan të KOSTT.

Dallimi në mes të vlerësimeve të studimit të parafizibilitetit dhe atyre të Kelkos Energy ka të bëjë me numrin dhe fuqinë instaluese të HEC-eve. Si dhe mbase dallimi eventual në çmimet e pajisjeve në kohë të ndryshme të projektimit (Studimi i fizibilitetit 2006 ndërsa Kelkos Energy 2011). Megjithatë problematike mbetet dallimi në investime mes projekteve dhe realizimeve të vetë kompanisë Kelkos. Ky dallim kap shumën prej 14,242,577 euro. Kjo nuk është shumë e vogël, pasi që përbën mbi 26% të vlerës së gjithmbarshme të investimeve të projektuara

> Kelkos Energy: Investimet e përealizuara dhe fryerja e dobisë ekonomike e sociale për banorët e zonës

1. Investimet nuk janë realizuar siç janë planifikuar. Sipas Adem Lushajt, banor i zonës dhe aktivist, premtimet për investime në rimëkëmbjen mjedisore dhe të projekteve tjera në dobi të komunitetit nuk janë realizuar asnjëherë. Aty ishin premtuar se do të renovohet rruga, do të vendosen mbrojtëset që të parandalohet degradimi i shtratit të lumit, do të rregullohet shtrati i lumit, si dhe do të ndërtohet një park në komunën e Deçanit në shërbim të komunitetit.

Asnjë prej këtyre investimeve nuk janë realizuar ose janë realizuar pjesërisht dhe sipërfaqësisht (sikur rasti i parkut ku Kelkos Energy ka investuar në vendosjen e disa ulëseve duke e bërë të duket sikur park). Rruga nuk është renovuar asnjëherë. Madje Kelkos Energy kishte penguar ndërtimin e rrugës me preteksin se kjo ia dëmton gypat e vendosur nën tokë për bartjen e ujit. Janë diku rreth 10 km gypa uji të vendosur nën tokë.

Shtoja këtu pastaj edhe premtimin për vende pune të cilën e kishin përdorur përfaqësuesit e kompanisë në takimet publike. Asnjë person nga komuniteti nuk është i punësuar në këto HEC, ndërkohë që numri i përgjithshëm i të punësuarëve aty është shumë i vogël për shkak të procesit të automatizuar të prodhimit.

2. Investimet dhe dobia ekonomike e sociale për banorët e zonës janë fryrë qëllimisht – kjo për ta marrë miratimin e banorëve të zonës për ndërtimin e HEC-eve, obligim ky kushtetues e ligjor.



> Koncesioni vs. Leja ujore

Ligji për ujërat në Kosovë përcakton që e drejta ujore 'për shfrytëzimin e fuqisë së ujit për prodhimin e energjisë elektrike' sigurohet me koncesion (Neni 78 p.3.2 2013). Njëkohësisht, Ky ligj parasheh që shuma e cila realizohet nga kontrata e koncesionit të derdhet në Buxhetin e Republikës së Kosovës, për t'u siguruar kështu që uji të përdoret në funksion të së mirës së përgjithshme dhe përfitimit publik.

Studimi i parafizibilitetit që ka shërbyer si bazë për iniciimin e ndërtimit të HEC-eve gjithashtu ka përcaktuar procedurën e koncesionit për ndarjen e të drejtës ujore për HEC-et e identifikuara dhe propozuara.

Sipas parafizibilitetit dhënia e koncesionit nuk mund të bëhet pa i pasur së pari të përfunduara këto studime:

- Studimi hidrologjik,
- Studimi gjeologjik,
- Studimin teknik në lidhje me parametrat kryesorë të projektit,
- Studimin e lidhjes së centralit me rrjetin,
- Studimi mjedisor.

Ndërkohë që përzgjedhja e ofertës fituese do të bëhet në bazë të këtyre kriterëve:

- Madhësia e investimit,
- Numri i të punësuarve në central,
- Zënia e sipërfaqeve të tokës bujqësore,
- Menaxhimi i ndotjes së mjedisit etj.

> Përparësi koncesionit jotransparent në dëm të mjedisit

Së pari koncesioni do të ishte garë e hapur që do të lejonte kompani të ndryshme të konkurrojnë dhe kështu projektet hidroenergjetike të ishin me transparente e gjithëpërfshirëse.

Së dyti gara konkurruese do t'i vendoste autoritetet publike në pozicion të sigurimit të ofertës më të mirë për ekonominë e komunitetin e mjedisit ku zbatohen investimet hidroenergjetike.

Së treti kriteret e përcaktuara do të siguronin oferta që do t'i merrnin parasysh parametrat mjedisor, social e ekonomik të hapësirës ku zbatohen investimet dhe kapacitetet hidroenergjetike do të mund të ndërtoheshin pa i dëmtuar interesat mjedisore e ato komunitare.

> Kelkos Energy dhe shkelja e Ligjit për Ujërat

E drejta për shfrytëzim të ujit në rastin e HEC-eve në kaskadën e Lumbardhit të Deçanit është dhënë pa koncesion dhe pa proces konkurrues - përmes lejes ujore - duke qenë kjo në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Ujërat e Kosovës si dhe në kundërshtim me praktikatat që zbatohen në këto

raste kundërshtim me praktikatat që zbatohen në këto raste.

Për më tepër leja ujore e lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë vitit 2012 përcakton që:

- Të dorëzohet në MMPH dokumentacioni pronëso- juridik në afat prej 60 ditësh,
- Të hartohet dokumentacioni shtesë si vijon:
- Elaborati hidrologjik me bilancin e ujërave për profilin e marrjes;
- Plani i i veprimit;
- Të dhënat për prodhimin vjetor të energjisë;
- Të dhënat për pranimin e plotës;
- Hartimi i elaboratit për minimumin biologjik të ujërrjedhës në profilet karakteristike;
- Dispozita ideore e hidrocentralit në planin horizontal dhe në prerje të objekteve, duke përfshirë zgjidhjen teknike të stazës së lëvizjes së eshqve dhe zgjidhjes teknike të mbrojtjes së tyre nga turbinat;
- Analiza e regjimit të aluvioneve në profilet karakteristike;
- Ky dokumentacion duhet të dorëzohet në afat prej 90 ditësh.

Pra leja ujore i është lëshuar Kelkos Energy pa i pasur gati dokumentacionin e kërkuar. Që i bie praktikisht që në momentin e lëshimit të lejes MMPH nuk ka pasur të dhëna të mjaftueshme për të marrë vendim.

Së pari mospërdorimi i procedurës së dhënies me koncesion e cila ia pamundëson autoritetit publik zgjedhjen e ofertës më të mirë, pasi që ka vetëm një ofertë. Përmbi këtë mungesa e dokumentacioni të kërkuar që ia pamundëson autoritetit publik ta kuptojë dhe vlerësojë cilësinë e investimit.

Kjo është një ikje e dyshkallëshme nga mundësia për ta mbrojtur interesin publik.

Dëmet mjedisore

> Shfrytëzimi i tërë kapacitetit ujqor dhe shkatërrimi i vegjetacionit e habitatit natyror

Sëkëndejmij HEC paraqesin një sfdë mjedisore për Grykën e Deçanit. Rritja e kapaciteteve energjetike prej atyre të planifikuara e ka fut në përdorim TËRË kapacitetin ujqor të Lumbardhit. 100% e ujqit të lumit futet në gypa dhe përdoret për prodhim të energjisë elektrike. Ky ujqë pastaj derdhet prapë në shtratin e lumit disa kilometra më poshtë. Por problemi qëndron në atë pjesë të konsiderueshme të shtratit të lumit, ku mungesa absolute e ujqit e shkatërron tërësisht vegjetacionin dhe habitatin natyror.

Përdorimi i 100% të ujqit e pamundëson mirëmbajtjen e prurjes ekologjike në këtë hapësirë natyrore. Standardet e ndërtimit të HEC-ëve parashohin që një sasi e ujqit të lëshohet e papenguar në shtratin e lumit. Kjo sasi e ujqit dallon nga rastinë rast dhe duhet të jetë e mjaftueshme për ta mirëmbajtur habitatin ekologjik brenda hapësirës mjedisore ku ndërtohen HEC-et.



Photo: Atthe Mulla

> Dëmtimi i potencialit turistik dhe bujqësor

Në rastin e Grykës së Deçanit kjo nuk respektohet. Ashtu siç nuk është respektuar as kriteri i përshtatjes së materialeve ndërtimore e dukjes së përgjithshme të HEC-eve me natyrës përreth. Materialet ndërtimore të përdorura kanë shkaktuar çakordim të pamjes së natyrës përreth që e dëmton mjedisin dhe potencialin turistik të tij.

Për më tepër se kaq mungesa e ujit në një pjesë të konsiderueshme të shtratit të lumit ia ul potencën turistike asaj pjese të zonës e cila këtë potencial turistik ka pasur mundësi ta shfrytëzonte për të tërhequr vizitorë të interesuar për bukurinë e bjeshkëve dhe freskinë e lumit. Kjo e fundit pamundësohet në së paku 10 km të shtratit të Lumbardhit.

Ndërsa nga këto HEC dhe devijimi i pjesshëm i ujit që ato bëjnë (nuk ka studime për ndikimin që ato mund të kenë në sasinë e ujit) paraqesin edhe dëm bujqësor për një pjesë të komunitetit. Sipas Adem Lushajt kanali i cili e lidh fshatin Isniq me ujin e Lumbardhit gjendet përmbi pikën ku kthehet uji i përdorur për energji elektrike në shtratin e lumit. Sëkëndejmi ky kanal nuk e ka sasinë e mëparshme të ujit për ta dërguar atë te toka bujqësore. Rrjedhimisht një sipërfaqe e konsiderueshme e tokave bujqësore mbesin me sasi të reduktuar të ujit për ujitje dhe kjo e ndikon negativisht rendimentin. Ky problem nuk shfaqet për të gjithë banorët e zonës, por vetëm për një pjesë të tyre.

Sipas Bajram Gjocit, banor i fshatit Rashiq të Decanit, faza e punimeve për testimin e bazenit akumulues në Zallin e Rupës ka qenë proces i eksploatimit të zonës përgjatë të cilit është marrë zalli nga shtrati i lumit dhe është përdorë për nevojat e kompanisë (Kelkos). Pas përfundimit të punimeve aty, nuk është bërë rehabilitimi i zonës dhe si pasojë komuniteti që kalon verën në Bjeshkën e Zallit të Rupës e ka shumë të vështiresuar, gati se të pamundur zhvillimin e veprimtarisë së blegtorisë aty. Kjo ka qenë ndër gjenerata një prej veprimtarive më të zakonshme e levërdishme ekonomike për banorët e zonës.

Aktualisht në këtë zonë janë shtatë stane të blegtorëve të cilat vazhdojnë të jenë në përdorim. Ndërsa para fillimit të ndërtimeve nga Kelkos në këtë zonë ka pasur afërsisht 50 stane në përdorim.

Përveç dëmtimit të rrugës dhe shtratit të lumit e cila e vështirëson shumë kalimin për në stane është dëmtuar edhe një pjesë e madhe e kullosës përgjatë bregut të lumit e cila është përdorur për bagëtitë përgjatë verës. Si pasojë e mungesës së kullosës, Gjoci thotë se është detyruar të shes kopenë e deleve prej 150 krerëve dhe të zvogëloj numrin e lopëve.

9. Rekomandimet

1. Të specifikohen në mënyrë më rigoroze detajet e mbajtjes së debatit publik, të obligueshme me Kushtetutë dhe ligj, përfshirë hapësirën ku mbahen, veçanërisht formën e diskutimit, duke pasur parasysh të mëposhtmet:

- Hapësira të jetë e qasshme për qytetarët
- Të mbahen së paku 3 dëgjime publike për secilën liçencë
- Organizimi të bëhet nga institucionet përgjegjëse
- Publikimi i thirrjes të bëhet në më shumë burime të informacionit, si dhe ato të jenë të kombinuara në mënyrë që të përfshijnë audiencë sa më të madhe.

2. Në rast të vendosjes për ndërtimin e hidrocentraleve, liçenca të jipet përmes procedurës së dhënies me koncesion, e cila i mundëson autoritetit publik që ta bëjë përzgjedhjen e ofertës më të mirë, duke pasur disa ofertues, e jo përmes lejes ujore e cila i jepet një kompanie të vetme. Ankandi për koncesion mundëson arritjen deri te oferta më e mire, që i merr parasysh parametrat mjedisor, social e ekonomik, të hapësirës ku zbatohen investimet dhe kapacitetet hidroenergjetike.

3. Leja nga ZRRE të jetë në përputhje me parimin bazë të ndërtimit të hidrocentraleve, e që është ruajtja e minimumit ekologjik dhe të potencialit real hidrik të lumit (të parapara edhe në studimin e parafizibiletit), si dhe duke pasur parasysh prurjen e ujit e cila mund të përdoret për energji, pa e kompromituar rrjedhën e lumit, peisazhin, prurjen dhe habitatin e gjallesave në lum.

4. Premtimet e investitorëve të përfshihen në kontratë, bashkë me një klauzolë e cila parasheh shkëputjen e kontratës në rast të dështimit të realizimit së zotimeve nga ana e investitorëve, të tilla si ndërtimi i rrugës, parqeve, punësimit e investimeve tjera në përgjithësi.

5. Të definohet më qartë minimumi ekologjik nëpërmjet një formule të krijuar nga ekspertë të fushës, nëpërmjet së cilës definohet qartë koha e lejueshme që këto hidrocentrale mund të punojnë, sasia e ujit të cilin mund ta fusin në gypa për përdorim, varësisht prej prurjes së lumit dhe minimumi i sasisë së ujit që duhet të mbetet në lum.

6. Të bëhet vëzhgimi i vazhdueshëm i punës së hidrocentraleve nga ana e inspektoriatit përkatës, nëpërmjet inspektimeve të vazhdueshme e cila mundësohet fillimisht, duke rritur kapacitetet e këtij inspektoriatit.

7. Të vendoset një standard për materialet të cilat përdoren për ndërtimin e hidrove, në mënyrë që ato ndërtime të jenë në harmoni me ambientin përreth dhe kësijoj të ruhet peisazhi i zonës, në mënyrë që sa më pak të dëmtohet potenciali turistik.

8. Në kuadër të studimit të parafizibiletit të bëhet edhe një studim mbi ndikimin social të ndërtimit të hidrocentraleve në komunitet, duke marrë parasysh dëmtimin e bujqësisë, turizmit, infrastrukturës, ujit që përdoret për pije dhe për ujitje, ujërat nëntokësore e fusha të tjera, të cilat potencialisht mund të ndikohen nga ndërtimi.

Burimet

Zhvillimi i intervistave

Banorët e zonës (Smajl Demaj, BajramÇeku, AdemLushaj, Muharrem Lulaj, Jehona Lulaj, Artur Qorraj, Valton Marku, Zana Ramovic, Veton Binakaj, Granit Gashi)

Ekspertë të fushës (Afrim Lajçi);

Aktivistë të shoqërisë civile (Flutura Kusari, ValonXhabali, Adriatik Gacaferri, Agron Dida);

Zyrtarë të lartë të institucioneve përkatëse: Gani Berisha - Drejtor i Autoritetit Rajonal të Pellgjeve Ujore dhe Muhamet Malsiu - Drejtor i Departamentit për mbrojtjen e mjedisit dhe ujërave nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit;

Zyrtarë të Zyrës së Rregullatorit për Energji (Izet Rushiti dhe Afrim Ajvazi);

Deputetë të grupit joformal të gjelbër në Kuvendin e Kosovës (Mimoza Kusari).

Legjislacioni vendor

Ligji nr. 05/L-052 për energjinë termike

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11326>

Ligji nr. 05/L-085 për energjinë elektrike

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12744>

Ligji nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2631>

Ligji nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2716>

Ligji nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2708>

Ligji nr. 03/L-230 për Vlerësimin Strategjik Mjedisor

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2711>

Ligji nr. 03/L-160 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2669>

Ligji nr. 02/L-102 për Mbrojtjen nga Zhurma

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2586>

Ligji nr.05/l-079 për investimet strategjike në republikën e kosovës

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=13319>

Rregulla e Procedurës se Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të Reja Bazuar në Burimet e Ripërtrishme të Energjisë

<http://ero->

[ks.org/2017/Rregullat/Rregulla%20e%20Procedures%20se%20Autorizimit%20per%20Ndertimin%20e%20Kapaciteteve%20te%20Reja%20Bazuar%20ne%20Burimet%20e%20Ripertrishme%20te%20Energjise.pdf](http://ero-ks.org/2017/Rregullat/Rregulla%20e%20Procedures%20se%20Autorizimit%20per%20Ndertimin%20e%20Kapaciteteve%20te%20Reja%20Bazuar%20ne%20Burimet%20e%20Ripertrishme%20te%20Energjise.pdf)

Udhëzim administrativ mea nr. 01/2021 për autorizim mjedisor

<https://gzk.rks-gov.net/ActsByCategoryInst.aspx?Index=3&InstID=41&CatID=22>

Udhëzim administrativ mmph - nr .17/2015 për dhënien e lejes mjedisore komunale

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8177>

[Rregullore 350-135077/2015 per mbrojtjen e mjedisit \(Komuna e Pejës\)](https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11659)

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11659>

Regullore nr. 19/2013 për dhënien e lejes mjedisore (Komuna e Istogut)

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11529>

Udhëzimi administrativ nr.08/2020 për certifikatë/garancinë e origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga bashkëprodhimi me efikasitet të energjisë

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=33495>

Legjislacioni ndërkombëtar

Directive 2009/28/ec of the European Parliament and of the council

<https://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2009:140:0016:0062:en:PDF>

Directive 2003/30/ec of the European Parliament and of the council of 8 may 2003

<https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32003L0030&from=en>

Directive 2008/99/EC of the European Parliament and of the Council of 19 November 2008 on the protection of the environment through criminal law

<https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32008L0099&from=EN>

Dokumente strategjike për energjinë

Marrëveshja Stabilizim Asociim (Energjia dhe Mjedisi)

<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=11239>

Strategjia e Energjisë së Republikës së Kosovës (2017-2026)

https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/Strategjia_e_energjise_2017-26_.pdf

Planin Kombëtar i Veprimit për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë

[https://kryeministri-ks.net/wp-](https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/PLANI_KOMBETAR_I_VEPRIMIT_PER_BURIMET_E_RIPERTERITSHME_TE_ENE)[content/uploads/docs/PLANI_KOMBETAR_I_VEPRIMIT_PER_BURIMET_E_RIPERTERITSHME_TE_ENERGJISE_\(PKVBRE\)_2011-2020.pdf](https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/PLANI_KOMBETAR_I_VEPRIMIT_PER_BURIMET_E_RIPERTERITSHME_TE_ENERGJISE_(PKVBRE)_2011-2020.pdf)

Dokumente komunale

<https://kk.rks-gov.net/peje/plani-zhvillimor-komunal-i-pejes-2020-2028/>

Faqe të internetit

<https://kallxo.com/gjate/planet-per-hidrocentral-ne-lumbardh-nxisin-reagime/><https://kosovo.energy/%E2%80%8Bministri-kuci-vetem-nje-hidrocentral-ne-vend-ka-leje-mjedisore/>



Adresa: Rruga B, Residio 5, Hyrja B,
Nr. 15-1, Ndërtuesi Dervisholli – 10
000, Prishtinë – Republika e Kosovës
info@musineinstitute.org
www.musineinstitute.org